



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 120, Datë 22.07.2019

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENSCO TRADING (ALBANIA)” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE.**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2 gërma “d” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1 gërma “e”, nenit 10, pikat 1 dhe nenit 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s nr.109, datë 29.06.2016, si dhe nenit 19 pika 1 gërma “a” të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e bordit të ERE nr.96, datë 17.06.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.07.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licensimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, për licencimin e shoqërisë “ENSCO Trading (Albania)” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “ENSCO Trading (Albania)” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 438 Prot., datë 05.07.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Aplikimi i shoqërisë “ENSCO Trading (Albania)” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:
  - Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
  - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “e”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gërmat “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin tregtimit të energjise elektrike (neni 9, pika 4.8 gërmat a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, gërma “d” (vertetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë).
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, gërma “a” (vërtetimi për shlyerjen e detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore). Në përputhje me veprimtarinë për të cilën kërkohet licenca, do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11 pika 1 të *“Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”*, t’i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i ERE-s,

### **Vendosi:**

1. Fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “ENSCO Trading (Albania)” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar.
2. Ngarkohet Drejtorja e Licensimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

**KRYETARI I ERE**

**PETRIT AHMETI**